



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.815/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Arbërore Kadriu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i Arbërore Kadriu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me shenjën ZL.Anr.815/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.815/2017 me datën 10.11.2017 në ora 08:15, nga parashtruesja Arbërore Kadriu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën nuk ka pretenduar asnjë parregullsi vetëm se ka përshkruar Qendrat e Votimit si: 1801e/02, QV 1801e/03, QV 1801e/04, QV 1801e/05, QV 1801x/01,02,03, QV 1802e/01,02,04,05, QV 1802x/01,02,03, QV 1803e/02, QV1804e/01,02, QV1807e/03, QV1809e/01, QV1811e/01, QV1812e/01,02,03, QV1813e/01,02, QV1814e/01,03, QV1815e/01,02, QV1816e/01,1817e/01,02,1820e/01,03,1823e/01,1824e/02,03,06,08,09,010,012,013,014, QV 1825e/01, QV 1827e/01, 02, 03, QV1828e/01, QV1829e/01,02, QV1831e/02, QV1832e/02, QV1833e/01,02, QV1834e/01,02, QV1835e/01, QV1837e/01, QV1838e/01, QV1841e/01,02, QV1842e/01, QV1843e/02, dhe QV 1844e/02.

Parashtruesja e apelit si provë nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas shqyrtimit të apelit të parashtruar gjeti se nuk ka specifikuar asnjë parregullsi dhe se apeli përmban vetëm përshkrimin e disa qendrave të votimit dhe disa vendvotime pa asnjë lloj kërkesë për PZAP. Prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.815/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyheri Haxhiu



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*